



REPUBLIKA E KOSOVËS
RÉPUBLIK OF KOSOVO
RAPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E PEJËS MUNICIPALITY OF PEJA OPŠTINA PEĆ

REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI KOMUNAL PEJË

STATUTI

I

KOMUNËS SË PEJËS

Pejë, Shtator 2008.



Në bazë të nenit 12. pika 12.1.(a) dhe 12.3. të Ligjit Nr.03/L – 040 Për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28.datë: 04.Qershor 2008) Kuvendi Komunal Pejë, në mbledhjen e mbajtur me datë: 29.Shtator 2008, pas procedurës së diskutimit publik, miraton dhe jep në implementim këtë:

STATUT I KOMUNËS SË PEJËS

PJESA I. - DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

1.1.Statuti i Komunës është akti më i lartë juridik i Komunës që miratohet nga Kuvendi i Komunës.

1.2.Me këtë Statut rregullohet organizimi i brendshëm i Komunës dhe zbatimi i përgjegjësive të komunës dhe organeve të saj.

Neni 2

2.1. Përgjegjësitë e Komunës: ushtrohen, organizohen dhe menaxhohen në pajtueshmëri të plotë me ligjet të cilat rregullojnë përgjegjësitë e Komunës në pajtueshmëri me Statutin e Komunës dhe Rregulloren e Punës të miratuar nga Kuvendi i Komunës.

Statusi ligjor i komunës.

Neni 3.

3.1.Statuti i Komunës zbatohet brenda kufijve të Komunës së Pejës.

3.2.Komuna është person juridik. Si person juridik, komuna ka kompetenca, përpos tjerash, që:

- a) të padisë dhe të paditet në gjykata;
- b) të posedoj, dhe të menaxhoi pasurinë;
- c) mund të jetë pronare apo bashkëpronare e ndonjë Kompanije që është në interes të Komunës në raport me qytetarët;

- d) të lidh kontrata ;
- e) të punësoj stafin; dhe
- f) të angazhohet në aktivitetet e tjera që janë të domosdoshme për realizimin e përgjegjësiave të saj.

Neni 4.

4.1. Brenda territorit të saj, komuna ushtron përgjegjësit të cilat nuk i janë rezervuar shprehimisht me ligj institucioneve qendrore.

Simbolet

Neni 5.

5.1. Komuna ka të drejtë të përdor simbolet e veta, ndërmjet tjerash: stemen, vulat, emblemen dhe flamurin komunal, të cilat përcaktohen me vendim të posaqem të kuvendit komunal të miratuar me 2/3 e votave të anëtarëve të kuvendit.

5.2. Komuna e përdor vulën që përfshinë shenjen dhe emrin e komunës.

5.3. Simboli i komunës miratohet apo ndryshohet nga 2/3 e votave të kuvendit të komunës, pas konsultimit publik gjithëpërfshirës.

5.4. Asnjë subjekt dhe person tjetër përveq komunës nuk mund ta përdor emblemen dhe shenjat komunale apo simbolet pa autorizimin paraprak të dhënë nga organet kompetente komunale: kuvendi apo kryetari i komunës.

Organet komunale

Neni 6.

Organet e komunës janë:

I. Kuvendi i Komunës është organi më i lartë i komunës.

II. Kryetari i komunës është organi më i lartë ekzekutiv.

Gjuhët

Neni 7.

7.1. Anëtarët e bashkësiave etnike në kuadër të komunës kanë të drejtë të komunikojnë në gjuhën e tyre amtare me të gjitha organet e komunës dhe me të gjithë nëpunësit civil të komunës.

7.2. Mbledhjet e Kuvendit të Komunës, të komiteteve të tij, dhe të gjitha tubimet publike duhet të mbahen në gjuhët: shqip, serbisht dhe gjuhën boshnjake.

7.3. Të gjitha dokumentet zyrtare të komunës shtypën në tri gjuhë: shqip, serbisht dhe gjuhën boshnjake.

Aktet e organeve komunale

Neni 8.

- 8.1. Kuvendi i Komunës dhe Kryetari kanë të drejtë të miratojnë akte dhe të ndërmarin masa për zbatimin e tyre brenda fushës së kompetencave të tyre.
- 8.2. Të gjitha aktet komunale duhet të jenë në përputhje me sistemin kushtetues dhe ligjor të Republikës së Kosovës.

Aktet e Kuvendit të Komunës

Neni 9.

- 9.1. Aktet e miratuara nga Kuvendi i Komunës së Pejës vlejnë në territorinë e komunës, dhe ato akte janë:
- a) Statuti i Komunës,
 - b) Rregullorja e punës,
 - c) Rregullorët komunale, dhe
 - d) Të gjitha aktet tjera të nevojshme për ushtrimin e funksionit efikas të komunës.
- 9.2. Miratimi, ndryshimi dhe plotësimet eventuale të statutit të komunës bëhen me votimin e 2/3 të anëtarëve të kuvendit të komunës.
- 9.3. Rregulloret dhe aktet tjera miratohen nga kuvendi me shumicë votash përjashtimisht ato që janë të përcaktuara ndryshe me ligj.

Aktet e kryetarit të komunës.

Neni 10.

- 10.1. Kryetari i komunës ka të drejtë të nxjerrë urdhëresa dhe vendime brenda fushës së kompetencave të tijë të përcaktuara me ligj.

Pasuria e Komunës

Neni 11.

- 11.1. Komuna ka të drejtë të posedoj dhe të menaxhoi pasuri të lujtshme dhe të pa lujtshme.
- 11.2. Komuna ka të drejtë të shes dhe të jap me qira pasurin e lujtshme dhe të pa lujtshme sipas ligjit, me përjashtim të shitjes së tokës e cila rregullohet me ligj të posaçëm.

11.3. Komuna mban dhe udhëheq Regjistrin e pronës së lujtshme dhe të palujtshme që e ka në shfrytëzim dhe posedim.

Neni 12.

12.1. Komuna ka ditën e festes së saj publike.

12.2. Dita e Pejës, festohet me 16. Qershor të çdo viti. Me rastin e ditës së Pejës, Kuvendi i Komunës, Kryetari i Komunës dhe qytetarët e saj përkujtojnë dëshmorët dhe viktimat e luftës të rënë për lirin e Kosovës. Manifestimi duhet të ketë karakter historik (përkujtues), kulturor, sportiv e civilizues me synime të bashkëpunimit me komunat e Republikës së Kosovës dhe jashtë saj, duke shpalosur vlerat kombëtare e qytetëruese të qytetarëve të saj.

PJESA E II – PËRGJEGJËSITË DHE PUSHTETI I KOMUNËS

Kompetencat komunale

Neni 13.

13.1. Komuna ushtron kompetencat vetanake, të deleguara dhe të zgjeruara në përputhje me ligjin.

Kompetencat vetanake

Neni 14.

14.1. Komuna ka kompetenca të plota dhe ekskluzive, për sa i përket interesit lokal, duke i respektuar standardet e përcaktuara me legjislacionin e zbatueshëm, në fushat që vijonë:

- a) zhvillimi lokal ekonomik;
- b) planifikimin urban dhe rural;
- c) shfrytëzimin e tokës dhe zhvillimin;
- d) zbatimin e rregulloreve të ndërtimit dhe standardeve për kontrollimin e ndërtimit;
- e) mbrojtjen e mjedisit lokal;
- f) ofrimin dhe mirëmbajtjen e shërbimeve publike dhe shërbimeve komunale, përfshirë furnizimin me ujë, kanalizimin dhe drenazhin, trajtimin e ujrave të zeza, menaxhimin e mbeturinave, rrugëve lokale, transportin lokal dhe skemave të nxehjes lokale;
- g) përgjigj ndaj rasteve emergjente lokale;
- h) ofrimin e arsimit publik parashkollor, fillor dhe të mesëm, duke përfshirë rregjistrimin dhe licencimin e institucioneve edukative,

- punësimin, pagesen e rrogave dhe trajnimin e instruktoreve dhe administratorëve të arsimit;
- i) promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut;
 - j) ofrimin e përkujdesit publik primar shëndetësor;
 - k) ofrimin e shërbimeve familjare dhe shërbimeve të tjera të mirëqenjes sociale, siç është përkujdesi për të cenushmit, strehimin familjar, përkujdesin fëmijëror, përkujdesin për të moshuarit, duke përfshirë regjistrimin dhe licencimin e këtyre qendrave përkujdesëse, punësimin, pagesen e rrogave dhe trajnimin e profesionistëve të mirëqenjes sociale;
 - l) banimin publik;
 - m) shëndetësin publike;
 - n) licensimin e shërbimeve publike dhe objekteve duke përfshirë ato që kanë të bëjnë me arzetimin, aktivitete kulturore dhe të lira, ushqimin, strehimin, tregjet, shitësit në rrugë, transportin lokal, publik dhe taxistët;
 - o) emërimin e rrugëve, rrugicave dhe vendeve të tjera publike;
 - p) ofrimin dhe mirrëmbajtjen e parqeve dhe hapësirave publike;
 - q) turizmi;
 - r) aktivitetet kulturore dhe të lira;
 - s) çdo çështje tjetër që nuk është përjashtuar shprehimisht nga kompetenca e saj apo që nuk është përcaktuar një autoritet tjetër.

Kompetencat e deleguara dhe të zgjeruara të komunës

Neni 15.

15.1. Në pajtim me Ligjin mbi vetëqeverisjen lokale, nenin 18 e 19 komuna ushtron kompetenca të deleguara dhe të zgjeruara.

PJESA III - FSHATRAT, VENDBANIMET DHE LAGJET URBANE

Neni 16.

16.1. Komuna e Pejës është e përbërë prej fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane të përfshira në 27 Bashkësi Territoriale, nga të cilat 13. Bashkësi Territoriale në qytet dhe atë si vijon: B.T. "Sahat Kulla", "Qendra", "2 Korriku", "Kapeshnica", "Karagaqi", "Haxhi Zeka", "Xhemajl Kada", "Rrokaqielli", "Kristali", "7. Shtatori", "Dardania I", "Dardania II", dhe "Dardania III". dhe 14 Bashkësi Territoriale në fshatra, si vijon: B.T. Baran", Gllogjan, Kryshec, Poqestë, Raushiq, Leshan, Zahaq, Nabergjan, Trestenik, Treboviq, Vitomiricë, Radavc, Osdrim dhe Rugovë.

MARRËDHËNIET ME FSHATRA, VENDBANIMET DHE LAGJET URBANE

Neni 17.

17.1. Në pajtim me nenin 34 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Statutin e komunës dhe Rregullorët lokale, Komuna bënë marrëveshje me lagjet urbane, fshatrat dhe vendbanimet tjera përbrenda territorit të saj për sigurimin e përmbushjes së nevojave të banorëve në komunë.

17.2. Objekt i marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet komunës e fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane mund të jenë të gjitha çështjet që janë në kompetencë vetanke të komunës, duke përfshirë:

- Planifikimi urban dhe rural,
- furnizimin me ujë, rregullimi i kanalizimit, drenazhimit;
- shëndetësin publike;
- mbrojtjen lokale të ambientit;
- turizmin;
- hapësirave të hapura dhe varrezave;
- aktivitetet kulturore dhe sportive e të tjera.

17.3. Objekt i marrëveshjes nuk mund të jenë përgjegjësit e kuvendit të komunës të përcaktuara me nenin 40.2. të Ligjit për Vetëqeverisjen lokale e që nuk mund të bartën në organet tjera.

Neni 18.

18.1. Komuna në kuadër të ushtrimit të kompetencave të saja, me vendim të posaçëm cakton hapjen e Zyrave Komunale për zona të caktuara, përcakton fushëveprimin e tyre, personelin si dhe siguron fonde të nevojshme për funksionimin e tyre.

PJESA E IV: KONSULTIMET DHE PJESËMARRJA E PUBLIKUT

KAPITULLI I: KONSULTIMET ME PUBLIKUN

Neni 19.

19.1. Komuna duhet ta konsultoj publikun në mënyrë që të sigurojë që vendimet e marra janë të bazuara fuqishëm në fakte dhe që janë marrë parasysh pikëpamjet dhe përvojat e qytetarëve si dhe janë përdorur mundësitë e reja dhe kreative para marrjes së vendimit, në mënyrë që të gjitha vendimet e propozuara mund të implementohen efektivisht në praktikë.

19.2 Komuna gjithashtu duhet të siguroj që: qytetarëve t'ju ipet mundësia ta shprehin mendimin e tyre dhe se interesat dhe kërkesat e tyre janë marrë parasysh.

Neni 20.

20.1. Komuna mund të shfrytëzoj secilën nga format e konsultimit të shënuara më poshtë: (si dhe format tjera të konsultimeve sipas nevojës dhe rrethanave):

1. Fushatat informative dhe të publicitetit për të promovuar aktivitetet dhe programet komunale;
2. Kontaktet me grupet profesionale, për t'i testuar dhe diskutuar politikat;
3. Anketat për implementimin e politikës, duke përfshirë përveç tjerash, anketën informuese dhe kyçe që lidhet në mënyrë të drejtëpërdrejtë me qytetarët e prekur nga kjo;
4. Shpalljet publike të propozimeve për politika apo draft rregulloret, duke thirrur për pjesëmarrje në prezantime;
5. Kontaktet dhe mbledhjet me grupet e interesit;
6. Takimet publike;
7. Dëgjimet publike;
8. Studimet për vlerësim të efektit.

Neni 21.

21.1. Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, Kryefari i Komunës dhe Komitetet e Kuvendit të Komunës duhet ta kenë autoritetin të mbajnë konsulta publike për çdo çështje që janë në kompetencat e tyre.

Neni 22.

22.1. Komuna para aprovimit të rregulloreve komunale praktikon mënyrën e gjerë të konsultave paraprake publike duke ju ofruar informata të nevojshme publikut të interesuar përmes formave si vijon:

- a) publicitet dhe fushatë informative për ngritjen e vetëdijesimit për propozim,
- b) kontakt me grupet fokuse, dhe palët e interesuara, për ti testuar dhe diskutuar propozimet,
- c) shpalljet publike të propozimeve,
- d) ftesat për përfaqësuesit dhe lejimi i së pakut 14 ditëve për ti shprehur pikëpamjet e tyre dhe
- e) studimet për vlerësimin e ndikimit.

Neni 23.

23.1 Të gjitha komunikimet në lidhje me konsultimet duhet të jenë të qarta dhe duhet të përfshijnë të gjitha informatat e nevojshme për t'i lehtësuar përgjigjet. Një dokument konsultues duhet të përfshijë një përmbledhje prej dy faqesh më së

shumti, të çështjeve dhe të pyetjeve kryesore për të cilat janë kërkuar mendimet e tyre; do të jetë më e lehtë për lexuesit të përgjigjen, të kontaktojnë apo të ankohen.

23.2 Kur përcaktohen grupet e fokusit në procesin e konsultimit, komuna duhet të siguroj që palët relevante kanë mundësi t'i shprehin mendimet e tyre.

Neni 24.

24.1. Komuna duhet të siguroj publicitetin e duhur dhe duhet t'i adoptoj kanalet komunikuese në mënyrë që të përmbushë synimet e audiencës. Pa përjashtuar mjetet tjera të komunikimit, konsultat e hapura për publikun duhet të publikohen në faqen zyrtare të komunës.

Neni 25.

25.1. Komuna duhet të lejoj kohë të mjaftueshme për shqyrtimin e përgjigjeve dhe kontributeve me shkrim. Komuna duhet t'i lejojë së paku 8 javë për marrjen e përgjigjeve me shkrim për konsultimin e publikut, ndërsa standardi duhet të jetë 12 javë.

Neni 26.

26.1. Përgjigjet duhet të analizohen dhe rezultatet duhet të bëhen publike, duke iu kushtuar rëndësi mendimeve të shprehura në marrjen përfundimtare të vendimit. Rezultatet e konsultave të hapura me publikun duhet të vendosen në faqen zyrtare të komunës.

KAPITULLI II: TUBIMET ME PUBLIKUN

Neni 27.

27.1 Takimet me publikun duhet të mbahen në një sallë që është e mjaftueshme për pjesëmarrjen e publikut të interesuar. Komuna duhet të mbajë së paku dy takime me publikun çdo vit, një në gjashtëmujorin e parë dhe një tjetër në gjashtëmujorin e dytë.

27.2 Përveç kësaj, takimet tjera me publikun mund të mbahen, duke marrë parasysh se duhet të ekzistoj një interval prej dy muajsh ndërmjet dy takimeve.

Neni 28.

28.1 Vendi, data dhe koha e mbajtjes së takimit publik duhet të shpallen së paku dy javë para mbajtjes së takimit. Takimet publike duhet të mos mbahen në datat apo kohën që në përgjithësi nuk është e përshtatshme për pjesëmarrjen e komuniteteve të veçanta.

28.2 Përfaqësuesit e mediave duhet të lejohen të marrin pjesë në të gjitha takimet me publikun.

Neni 29.

29.1 Kryetari i **komunës** apo përfaqësuesit e tij/saj duhet ta kryesojnë mbledhjen me publikun. Ai/ajo duhet ta ketë autoritetin ta përcaktojë procedurën e cila do të shfrytëzohet gjatë mbledhjes si dhe ka autoritetin të mos lejoj diskutimin për disa çështje të caktuara që nuk janë të lidhura me çështjet e diskutuara apo që nuk janë në kuadër të pushtetit të komunës dhe nuk kanë të bëjnë me punët e komunës.

29.2 Ai/ajo mund të vendosë të mos i dëgjojë folësit të cilët prezantojnë pikëpamje të njëjta apo i përserisin ato dhe mund të përcaktojë një limit kohor për kohën të cilën e kanë në dispozicion folësit.

Neni 30.

30.1. Nëse bëhet një pyetje në takim publik, që nuk mund të ketë përgjigje gjatë takimit, pyetësi mund të kërkojë përgjigje me shkrim në një periudhë prej 30 ditësh, pas ditës së takimit.

Neni 31.

31.1. Procesverbalit i secilit takim publik duhet të ruhet me të gjitha informatat të hollësishme që jepen për komunë, si dhe të gjitha propozimet e bëra nga anëtarët e publikut dhe përgjigjet që janë dhënë në pyetjet e bëra. Një kopje e të gjitha përgjigjeve të dhëna me shkrim në ndonjë datë të mëvonshme duhet t'i bashkëngjiten procesverbalit të takimit.

Neni 32.

32.1. Komiteti për politikë dhe financa duhet ta shqyrtoj procesverbalin e mbledhjes publike brenda 60 ditëve pas mbledhjes. Komiteti duhet ta shqyrtoj secilin propozim të dhënë gjatë mbledhjes dhe pas kryerjes së konsultimeve të nevojshme të bëjë rekomandimet e duhura në takimin e ardhshëm të Kuvendit Komunal.

Neni 33.

33.1. Në pajtim me **nenin 69 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale**, çdo qytetar dhe person juridik që ka interes në komunë, ka të drejtë që me vetiniciativë përmes formës së peticionit ti propozoj Kuvendit të Komunës nxjerrjen e akteve juridike me të cilat do të zgjidhen çështjet e rëndësishme për qytetin, fshatin, vendbanimin dhe lagjen urbane në pajtim me rregulloren dhe statutin.

33.2. Subjektet e përmendura më lartë mund ti drejtojnë peticion Kuvendit të Komunës për çështjet që janë në kompetencë të tij në mënyrë të pa kufizuar e që kanë të bëjnë me :

- a) rregullimin e qytetit,
- b) mirëmbajtjen e rëndit dhe të infrastrukturës së komunës,
- c) urbanizimin e qytetit,
- d) mirëmbajtjen e mjedisit jetësor,

- e) implementimin e vetëkontrollit, organizimin e referendunit, dhe
- f) çështje të tjera të rëndësishme për jetën e popullatës vendore.

33.3. Një iniciativë e tillë e subjekteve fillon me nënshkrimin e tyre, në formë të peticionit, me propozimet e veçanta të çështjes së caktuar dhe i drejtohet Kuvendit të Komunës përmes **Zyrës së Pranimit të Drejtorisë për Administratë**.

33.4. Kuvendi i Komunës mund të delegoj shqyrtimin e peticioneve të tilla në Komisionin e përhershëm. Pavarësisht nga ajo që u tha, një peticion që është nënshkruar nga më shumë se 100 persona të regjistruar në listën e votuesve, Kuvendi i Komunës duhet ta shqyrtoj atë.

33.5. Çdo peticion duhet të përmbaj emrin dhe adresën e parashtruesit, emrat dhe adresat e nënshkruesve si dhe lëndën e peticionit. Lënda e peticionit duhet të ceket qartë në secilën faqe. Komunitetet mund të bëjnë peticion Kuvendit të Komunës përmes Komitetit të Komuniteteve.

33.6. Përmbajtja e informatës duhet të jetë siç është cekur më lartë. Një peticion i cili nuk përmban elementet e dhura, nuk do të konsiderohet i vlefshëm.

Neni 34.

34.1. Kryesuesi i Kuvendit në afat prej 30 ditësh çdo peticion të vlefshëm ja prezanton Kuvendit të Komunës nga dita që ai e pranon. Kuvendi i Komunës mund t'ia referoj për shqyrtim të mëtejme Komitetit të caktuar.

Në mbledhje të Kuvendit, me rastin e shqyrtimit, parashtruesit e peticionit kanë të drejtë të pjesëmarrjes së drejtpërdrejt me rastin e shqyrtimit.

34.2. Vendimin përfundimtar për çështjen e peticionit e merr Kuvendi i Komunës në afat prej 6 javësh nga dita e prezantimit të peticionit në Kuvend. Vendimi do të arsyetohet me shkrim dhe do të komunikohet parashtruesit të peticionit.

REFERENDUMI

Neni 35.

35.1. Për disa çështje me interes të përgjithshëm, që kanë të bëjnë me kompetenca të komunës për të cilat Kuvendi i Komunës për arsye të ndryshme nuk merr vendim përfundimtar, atëherë organizon referendum.

35.2. Mënyra e organizimit të kësaj mënyre të deklarimit të qytetarëve do të rregullohet me Ligjin për referendum.

35.3. Referendumi mund të organizohet edhe në kërkesë të qytetarëve për çështjet e përcaktuara me nenin 71. të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale.

PJESA E V - KUVENDI I KOMUNËS, KRYESUESI DHE ZËVENDËS KRYESUESI I KUVENDIT TË KOMUNËS

KAPITULLI I. - KUVENDI I KOMUNËS

Neni 36.

36.1. Kuvendi i Komunës është organi më i lartë në komunë dhe zgjidhet në mënyrë të drejtëpërdrejt nga qytetarët në pajtim me Ligjin mbi zgjedhjet lokale.

36.2. Mandati i anëtarëve të kuvendit është 4 (katër) vite.

36.3. Kuvendin e komunës e përbejnë 41 këshilltarë.

36.4. Anëtarët e kuvendit kanë të drejta të njëjta dhe mundësi për të marrë pjesë në proceset e kuvendit.

36.5. Kuorumi për të gjitha mbledhjet e kuvendit të komunës dhe komiteteve të tij përbëhet prej më tepër se gjysma e anëtarëve të kuvendit.

36.6. Në të gjitha takimet e kuvendit komunal dhe të Komiteteve e tij, çdo person përfshirë edhe kryesuesin, ka nga një votë, por kryesuesi ka një votë shtesë nëse votimi është i barabartë për ose kundër një propozimi.

36.7. Kuvendi Komunal dhe komitetet marrin vendime me votim të hapur, përveç nëse kërkohet ndryshe me këtë statut apo me rregulloren e punës.

36.8. Vendimet e Kuvendit të Komunës dhe propozimet e komiteteve të tij merren me shumicë të thjeshtë të anëtarëve të pranishëm dhe të cilët votojnë.

Neni 37.

37.1. Kuvendi i Komunës e miraton statutin, planin zhvillimor komunal, planin zhvillimor urban dhe rregullativ si dhe mund ta ndryshoi ato nëse konsideron se një ndryshim i tillë është i nevojshëm.

37.2. Çdo vendim për miratimin apo për ndryshimin e statutit duhet të aprovohet me 2/3 e anëtarëve të pranishëm të kuvendit.

37.3. Kuvendi i Komunës miraton Rregulloren e punës dhe mund ta ndryshoi atë nëse konsideron se një gjë e tillë është e nevojshme.

37.4. Rregullorja e punës duhet të siguroi udhëheqjen dhe kontrollin efikas financiar të administratës së komunës.

37.5. Vendimi për miratimin dhe ndryshimin e rregullores së punës aprovohet nga më shumë se gjysma e anëtarëve të pranishëm të kuvendit.

Neni 38.

38.1. Iniciativa për ndryshimin dhe plotësimin e statutit të komunës dhe rregullores së Punës së Kuvendit mund të merret nga: Kryetari i Komunës, 1/3 e anëtarëve të Kuvendit Komunal, dhe me iniciativën e 10% të banorëve me të drejtë vote në komunë.

Neni 39.

39.1. Procedura për hartimin dhe ndryshimin e rregulloreve komunale duhet të jetë siç vijon: Kryetari i komunës e bënë propozimin për hartimin e rregulloreve komunale lidhur me çështjet të cilat janë në suaza të autorizimeve komunale. Projekt - Rregullorja e hartuar i prezantohet për shqyrtim Komitetit për Politikë e Financa, i cili pas shqyrtimit (me apo pa ndryshime) ia propozon për miratim Kuvendit Komunal. Pas miratimit të projektit nga ana e kuvendit ai ipet në diskutim publik prej 14 ditësh dhe pas diskutimit publik rregullorja – teksti i spastruar i saj sipas vërejtjeve dhe sugjerimeve nga diskutimi publik, miratohet dhe jepet në implementim nga ana e kuvendit.

39.2. Rregullorja e miratuar nga kuvendi do të shpallet në WEB faqen e Kuvendit Komunal.

Neni 40.

40.1. Kuvendi i Komunës nuk mund të delegoj kompetencën e vetë për marrjen e vendimeve lidhur me:

- a) miratimin e buxhetit,
- b) miratimin e çështjeve tjera financiare, që sipas statutit dhe rregullores së punës i janë rezervuar kuvendit,
- c) kompensimet për këshilltarë të kuvendit,
- d) raportin vjetor,
- e) miratimin, ndryshimin dhe anulimin e rregulloreve lokale komunale,
- f) themelimin e komiteteve të përhershme dhe komiteteve tjera,
- g) zgjedhjen e kryesuesit të kuvendit dhe zëvendëskryesuesit të komuniteteve,
- h) lartësinë e tarifave, ngarkesave dhe gjobave komunale,
- i) krijimin dhe përdorimin e simboleve, dekoratave dhe titujve të nderit,
- j) emërimin dhe riemërimin e rrugëve, rrugicave dhe vendeve tjera publike, dhe
- k) bërjen e planeve dhe marrëveshjeve.

Mbledhja e parë dhe betimi apo deklarata e këshilltarëve

Neni 41.

41.1. Kuvendi Komunal mban mbledhjen e parë inauguruese brenda 15 ditëve nga data e vërtetimit të rezultateve zgjedhore. Përfaqësuesi më i vjetër i kuvendit e

kryeson çdo mbledhje deri sa kryesuesi ta ketë dhënë betimin ose deklaratën solemne.

41.2. Këshilltarët e kuvendit të komunës e nënshkruajnë betimin apo deklaratën solemne.

Përmbajtja e betimit ose e deklaratës solemne është si vijon:

“Unë _____ betohem se do ti kryej me nderë, me besnikëri, pa anime e me ndërgjegje dhe sipas ligjit detyrat dhe do ti ushtroj autorizimet e mija si këshilltar i Kuvendit të Komunës së Pejës, në mënyrë që të sigurohen kushtet për një jetë të qetë për të gjithë”.

KAPITULLI II: KRYESUESI DHE ZËVENDËSKRYESUESI I KUVENDIT TË KOMUNËS

Neni 42.

42.1. Kuvendi i komunës e zgjedh kryesuesin e kuvendit të komunës nga radhet e anëtarëve,

42.2. Kryesuesi i kuvendit të komunës zgjidhet për një mandat të njëjtë sikurse anëtarët e kuvendit.

42.3. Votimi në të gjitha zgjedhjet për kryesues të kuvendit të komunës është me vota të fshehta.

42.4. Për tu zgjedhur në votimin e parë, kandidati duhet të marr më shumë se gjysmen e votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të zgjedhur.

42.5. Në rast se në votimin e parë asnjeri prej kandidatëve nuk e siguron shumicën e kërkuar atëherë të dy kandidatët me numrin më të madh të votave shkojnë në votimin e dytë. Kandidati që merr më shum se gjysmen e numrit të përgjithshëm të anëtarëve të zgjedhur do të zgjidhet kryesues i kuvendit të komunës.

Zëvendëskryesuesi i komuniteteve.

Neni 43.

43.1. Postin e Zëvendëskryesuesit të kuvendit të komunës për komunitete e mban kandidati përfaqësues i komunitetit jo shumicë, që ka marrë më shumë vota në listen e hapur të kandidatëve për zgjedhje në kuvendin e komunës konform nenit 54 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale.

Neni 44.

44.1. Zëvendëskryesuesi i Kuvendit të Komunës i thërret dhe kryeson mbledhjet e Kuvendit të Komunës në mungesë të Kryesuesit të kuvendit.

Neni 45.

45.1. Në mungesë të kryesuesit të kuvendit dhe në mungesë të zëvendëskryesuesit Rregullorja e Punës, rregullon se kush konvokon dhe kryeson mbledhjet e Kuvendit të Komunës.

Detyrat e zëvendëskryesuesit të Kuvendit të komunës për komunitete

Neni 46.

46.1. Zëvendëskryesuesi i kuvendit të komunës për komunitete promovon dialog ndërkomunal dhe shërben si pikë qendrore zyrtare për adresimin e brengave dhe interesave të komuniteteve jo shumicë në mbledhjet e kuvendit. Është përgjegjës për shqyrtimin e ankesave të komuniteteve apo pjesëtarëve të tyre, në mënyrë që aktet apo vendimet e kuvendit të komunës të mos i shkelin të drejtat e garantuara kushtetuese të tyre.

KAPITULLI III: KOMITETET E PËRHERSHME DHE KOMITETET TJERA

Neni 47.

47.1 Pas konstituimit, Kuvendi i Komunës formon Komitetet e përhershme dhe komitetet tjera në pajtim me **Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale**.

47.2 Numri i anëtarëve të kuvendit në secilin komitetet duhet të përcaktohet nga Kuvendi i Komunës.

47.3 **Kryesuesi i Kuvendit të Komunës** i propozon Kuvendit të Komunës anëtarët e komiteteve, që nuk janë anëtarë të Kuvendit të Komunës.

Neni 48.

48.1. Kuvendi i Komunës i formon dy komitete të përhershme:

1. Komitetin për Politikë e Financa, dhe

2. Komitetin për Komunitete

48.2. Pas komiteteve të përhershme kuvendi duhet të formon edhe komitetet tjera :

1. Komitetin për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale,

2. Komitetin për Arsim dhe Kulturë,

3. Komitetin për Zhvillim Ekonomik,

4. Komitetin për Planifikim Urban, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit.

48.3. Kuvendi Komunal mund të merri vendim për themelimin edhe të komiteteve tjera sipas nevojës.

48.4. Gjatë caktimit të anëtarëve të komiteteve të përhershme dhe komiteteve tjera, Kuvendi Komunal duhet të bëjë përpjekje që të siguroi baraspeshë gjinore në të gjitha komitetet.

48.5. Anëtarësimi në çdo komitet duhet të pasqyroj në mënyrë sa më të përafërt proporcionin e vendeve që i mbajnë partitë politike dhe koalicionet në kuvendin komunal.

48.6. Kryesuesi dhe zëvendëskryesuesi i çdo komiteti zgjidhet nga anëtarët e komitetit me përjashtim të kryesuesit të Komitetit për politikë e financa, të cilin në mungesë e zëvendëson zëvendëskryesuesi i kuvendit.

Neni 49.

49.1. Në takimin e tyre të parë në secilin vit fiskal Kuvendi Komunal dhe secili komitetet duhet t'i caktoj datat fikse në të cilat duhet të mbahen takimet e rregullta gjatë vitit. Datat e mbajtjes së takimeve mund të ndryshohen me vendime pasuese. Takimet tjera mund të thirren në çdo kohë.

Neni 50.

50.1. Të gjitha takimet duhet të thirren dhe mbahen në pajtueshmëri me rregulloren e punës. Personi i cili thërret apo udhëheqë takimet duhet të sigurojë që të gjithë anëtarët që marrin pjesë në mbledhje kanë të drejta të njëjta dhe të barabarta, dhe të kenë mundësi të marrin pjesë në të gjitha veprimet

Neni 51.

51.1 Mbledhjet e Kuvendit të Komunës dhe Komiteteve të Kuvendit Komunal janë të hapura për publikun përfaqësuesit e mjeteve të informimit dhe subjekteve të interesuara që është objekt diskutimi përveç në rastet që parashihen ndryshe me legjislacionin në fuqi.

51.2 Kuvendi i Komunës nëpërmjet Zyrës Përgjegjëse për Informim njofton Publikun të paktën 7 ditë para mbledhjeve të rregullta ose 3 ditë para mbledhjeve të jashtëzakonshme ndër të tjera me mjetet e mëposhtme:

- a) Shpallja publike në vendet më të frekuentuar brenda territorit të Komunës
- b) Medijat e shkruar dhe elektronike lokale dhe
- c) Faqen e Internetit të Kuvendit të Komunës

51.3 Njoftimet publike duhet të përmbajnë:

- a) Datën e mbledhjes
- b) Kohën e mbledhjes
- c) Vendin e mbajtjes së mbledhjes
- d) Rendin e ditës

51.4 Komitetet nëpërmjet zyrës përgjegjëse për informim njoftojnë publikun 3 ditë para ditës së caktuar për mbajtjen e mbledhjeve. Njoftimet publike përmbajnë:

- a) Datën e mbledhjes
- b) Kohën e mbledhjes
- c) Vendin e mbajtjes së mbledhjes
- d) Rendin e ditës.

Neni 52.

52.1. Çdo anëtar i publikut i cili merr pjesë në takimet e Kuvendit Komunal dhe komiteteve të tij, me lejen e kryesuesit të takimit, mund të bëjë pyetje dhe mund t'i drejtohet mbledhjes. Rregullorja e punës mund të rregulloj të drejtat dhe veprimet e udhëheqësit të mbledhjes gjatë ushtrimit të detyrës së tij.

Neni 53.

53.1 Të gjithë anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa duhet të emërohen nga radhët e anëtarëve të Kuvendit të Komunës. Anëtarësimi në çdo rast duhet të pasqyrojë në mënyrë sa më të përafërt proporcionin e nivelit të përfaqësimit të partive politike dhe përfaqësimin gjinor në Kuvendin Komunal.

53.2 Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa nuk kanë të drejtë të jenë edhe anëtarë të komiteteve tjera.

53.3. Komiteti për Politikë dhe Financa përbëhet nga 9 anëtarë.

53.4. Mbledhjet e komitetit për Politikë dhe Financa kryesohen nga **kryesuesi i kuvendit** i cili duhet të vendos edhe për çështjet të cilat duhet të shqyrtohen në këtë komitet. Kur kryen detyrën e kryesuesit, **kryesuesi** ka të drejtën e votës vendimtare nëse ka numër të barabartë të votave për dhe kundër propozimit. Në mungesë të Kryesuesit, zëvendëskryesuesi i komiteteve i kuvendit komunal e kryeson komitetin në pajtim me rregulloren e punës.

Neni 54.

54.1 Anëtarët e Komitetit për Komunitete emërohen nga Kuvendi i Komunës nga radhët e anëtarëve të Kuvendit të Komunës dhe përfaqësuesve të komiteteve pakicë.

Neni 55.

55.1. Komiteti për Komunitete përbëhet nga 7 anëtarë, ku përfshihen anëtarë të kuvendit dhe përfaqësues të komiteteve, nga të cilët anëtarë nga komuniteti shumicë duhet të jenë më pak se gjysma e numrit të përgjithshëm të anëtarëve të komitetit.

55.2. Çdo komunitet që jeton në komunë duhet të përfaqësohet së paku me një anëtar në komitetin për komunitete.

Neni 56.

56.1. Fushëveprimi dhe përgjegjësitë e komiteteve të përhershme : Komitetit për Politikë e Financa, dhe Komitetit për Komunitete, janë përcaktuar me nenin 52 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale.

Neni 57.

57.1 Komitetet e përhershme, në përbërjen e tyre shumica e anëtarëve të këtyre komiteteve emërohen nga anëtarësia e Kuvendit të Komunës, duke respektuar përfaqësimin e partive politike dhe përfaqësimin gjinor.

57.2 Emërimi i anëtarëve jashtë Kuvendit të Komunës duhet të bëhet duke respektuar përvojën adekuate dhe kriteret profesionale.

Komitetet tjera si komitete këshillëdhënëse:

Neni 58.

58. Kuvendi Komunal mund të krijoj komitete këshillëdhënëse sektoriale që do të mundësonin pjesëmarrjen e qytetarëve në procesin e vendimmarrjes. Në emërimin e anëtarëve të këtyre komiteteve, kuvendi komunal duhet të siguroi një përfaqësim të gjerë nga sektorët e ndryshëm të shoqërisë, në krijimin e këtyre komiteteve duhet të mirret parasysh balanca gjinore dhe ato duhet të reflektojnë interesat e komuniteteve ekzistuese dhe /apo fshatrave brenda komunës.

Neni 59.

59.1. Komiteti për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, përbëhet nga 7 anëtarë, ku shumica e anëtarëve duhet të jenë nga anëtarësia e kuvendit komunal.

59.2. Komiteti në fjalë në fushëveprimin e tij kryen këto detyra:
Këshillon Kuvendin Komunal në çështje që kanë të bëjnë me shëndetësinë dhe mirëqenien sociale, monitoron punën e Drejtoratit për Shëndetësi dhe Mirëqenje Sociale në çështjet që lidhen me politikën shëndetësore dhe sociale në Komunë dhe bënë rekomandime në pajtim me kornizën legjislative.

Neni.60.

60.1. Komiteti për Arsim dhe Kulturë, përbëhet nga 7 anëtarë.

60.2. Fushëveprimi i këtij komiteti është si vijon:
Ky komitet monitoron punën e Drejtoratit për Arsim dhe Kulturë, në çështjet që kanë të bëjnë me politikën edukative e kulturore të komunës, e këshillon kuvendin komunal dhe Drejtoratin në çështjet të cilat kanë të bëjnë me edukimin parashkollor, fillor të mesëm, për politikën kulturore dhe njëherit bënë rekomandime në përputhje me kornizën legjislative.

Neni 61.

60.1. Komiteti për Zhvillim Ekonomik, përbëhet nga 7 anëtarë.

60.2. Komiteti në fjalë është përgjegjës për politikën të cilat kanë të bëjnë me përkrahjen e zhvillimit ekonomik të komunës, përfshirë këtu organizimin e panairëve të tregtisë dhe tregjeve, tërheqjen e biznesit dhe turizmit si dhe

bashkëpunimin në bizneset lokale etj. I jep këshilla dhe rekomandime Drejtorisë përkatëse dhe Kuvendit.

Neni 62.

62.1. Komiteti për Planifikim Urban, Kadastër dhe Mbrojtjen e ambientit, përbëhet nga 7 anëtarë.

62.2. Komiteti në fjalë bënë monitorimin e punëve të Departamentit për planifikim, urban, kadastër dhe mbrojtje të mjedisit, në çështjet që kanë të bëjnë me banimin, ndërtesat publike, turizmin, mbrojtjen e mjedisit, zonat për shfrytëzimin publik (siç janë: parqet, hapësirat rekreative, hapësirat gjelbëruese dhe sheshet e lojrave dhe transportin publik), ndihmon dhe këshillon Kuvendin Komunal dhe departamentin në hartimin e politikave që kanë të bëjnë me çështjet e lartcekura. Poashtu bënë rekomandime për zgjedhjen e problemeve si dhe hartimin e rregulloreve për fushat në fjalë.

KAPITULLI IV: INFORMIMI PËR ANËTARËT E KUVENDIT TË KOMUNËS

Neni 63.

63.1 Kërkesat për informata që kanë të bëjnë me çështjet komunale, të cilat bëhen nga anëtarët e Kuvendit Komunal, duhet të adresohen me shkrim tek zyrtari apo Drejtorija përgjegjëse e komunës nga e cila kërkohet informata.

63.2 Zyrtari përgjegjës i Komunës në afat prej 15 ditëve duhet ti përgjigjet me shkrim anëtarit ose anëtarëve të Kuvendit të Komunës.

63.3 Një kopje e kërkesës dhe e përgjigjes duhet të futet në regjistër nga Zyrtari i komunës, i cili duhet ta shënoj datën e kërkesës së marrë dhe datën përgjigjes së dhënë.

Neni 64.

64.1. Informatat të cilat bien në kategorinë e përcaktuara në bazë të kushteve të caktuara duhet të mos jenë të hapura. Arsyet për një veprim të tillë duhet t'i jepen anëtarëve dhe duhet të ruhen në regjistër.

KAPITULLI V: KOMPENSIMI I ANËTARËVE TË KUVENDIT TË KOMUNËS

Neni 65.

65.1. Kompensimi për anëtarët e Kuvendit të Komunës, komisionet e kuvendit dhe anëtarëve të komiteteve për punën që ata e bëjnë për komunën do të caktohet nga

kuvendi në propozim të KPF.-ca, konform Udhëzimit Administrativ për pagesën e stafit politikë të komunave që ipet nga Autoriteti Qendror i Kosovës.

KAPITULLI VI: KONFLIKTI I INTERESIT I ANËTARËVE TË KUVENDIT TË KOMUNËS

Neni 66.

66.1. Anëtarë të Kuvendit të Komunës nuk mundë të jen: drejtorët komunal, drejtorët e instituconeve dhe ndërmarrjeve nën autoritetin e komunës si dhe nëpunësit civil të administratës.

Neni 67.

67.1. Anëtarët që kanë konflikt të interesit në lidhje me një çështje të caktuar, nuk duhet të flasin e as të votojnë për çështjen për të cilën kanë konflikt të interesit, dhe duhet të dalin nga salla e mbledhjes atëherë kur diskutohet ajo çështje.

Neni 68.

68.1 Nëse vije deri të ndonjë konflikt potencial i interesit pasi që është marrë vendimi, por para se të implementohet ai, vendimi duhet të suspendohet dhe çështja duhet të hetohet.

68.2 Nëse arrihet në përfundimin se ka ekzistuar konflikti i interesit, vendimi duhet të anulohet tërësisht dhe duhet të bëhet një votim i ri.

KAPITULLI VII: MARRËDHËNIET NDËRKOMUNALE

Neni 69.

69.1. Kuvendi Komunal vendos për bashkëpunim si dhe për lidhjen e marrëdhënieve miqësore dhe bashkëpunim tjetër me komunat tjera brenda dhe jashtë Kosovës.

69.2. Kryetari i Komunës, pas konsultimeve me Komitetin për Politikë dhe Financa duhet të prezantoj rekomandimet për Kuvendin Komunal, për marrëveshjet të cilat mund të jenë të nevojshme në bazë të nenit 28 dhe 29 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale.

69.3. Kuvendi i komunës vendos për lidhjen e marrëveshjeve ndërmjet komunave për ushtrimin e përgjegjësiave dhe pushtetit në bashkëpunim me njera tejtren.

Neni 70.

70.1. Kuvendi komunal mund, që brenda kornizës së ligjit, të bëj marrëveshje që të bashkëpunoj dhe të formoj partneritete me kuvendet tjera komunale ashtu që të kryejnë detyrat që janë në interes të përbashkët.

Neni 71.

71.1. Kuvendi komunal mund të bashkohet me kuvendet tjera komunale në asocionime për mbrojtjen dhe promovimin e interesave të përbashkëta.

KAPITULLI VIII: PROCEDURAT BUXHETORE

Neni 72.

72.1. Të gjitha çështjet që janë të lidhura me administrimin financiar të komunës janë përgjegjësi e Kryetarit të Komunës, të cilat përgjegjësi edhe mund të barten tek Drejtori i Departamentit për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim. Përjashtim nga këto çështje bëjnë ato që janë të rezervuara për Kuvendin Komunal dhe Kryetarin e komunës.

72.2. Kryetari i komunës raporton para Komitetit për Politikë e Financa dhe kuvendit të komunës për situatën ekonomike financiare të komunës dhe për zbatimin e planeve investuese të komunës, së paku njëherë në gjashtë muaj apo kurdoherë që kërkohet nga kuvendi i komunës apo komitetit.

72.3. Drejtori i Drejtorisë për Financa, Ekonomi e Zhvillim duhet të informoi rregullisht kryetarin e komunës për çështje lidhur me menaxhimin financiar. Ai/ajo duhet të raportoi Komitetit për Politikë e Financa për menaxhimin financiar duke ia referuar atij të gjitha raportet dhe korrespondencën e dërguar ose pranuar nga MEF. Ai/ajo duhet të ofroi një listë të hollësishme mujore me të gjitha zotimet e regjistruara, pagesat e bëra individuale, dhe një krahasim të shpenzimeve aktuale mujore me shpenzimet e buxhetuara.

Neni 73.

73.1. Drejtorët e Drejtorive të komunës do ta mbajnë kontrollin financiar dhe duhet të sigurojnë saktësinë dhe tërësinë e informatave financiare dhe sistemeve funksionuese brenda departamentit të tyre, si dhe duhet t'ia japin të gjitha informatat Drejtorit të Financave, Ekonomisë dhe Zhvillimit, dhe Auditorit të Brendshëm.

Neni 74.

74.1. Drejtori i Drejtorisë së Financave, Ekonomisë dhe Zhvillimit duhet të jep këshilla financiare Kryetarit të Komunës dhe Komiteteve të Kuvendit, përfshirë këtu edhe vlerësimin financiar të rregulloreve, vendimeve dhe politikave që shqyrtohen nga këto organe të Komunës.

Neni 75.

75.1. Rregullat, procedurat financiare dhe procedurat e prokurimit të komunës janë të përcaktuara nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave.

Neni 76.

76.1. Drejtori i Drejtorisë së Financave, Ekonomisë dhe Zhvillimit do të paraqesë procedura, rregullore dhe rregulla tjera financiare, që do të jenë në përputhshmëri me procedurat, rregullat dhe rregulloret e Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave për të promovuar një administrim të fortë financiar brenda komunës dhe nga personeli i komunës.

Neni 77.

77.1. Përcaktimi i të gjitha tatimeve, tarifave dhe pagesave, ndryshimi i tatimeve, tarifave dhe pagesave duhet të miratohet nga Kuvendi i Komunës.

Neni 78.

78.1. Drejtori i Drejtorisë së Financave, Ekonomisë dhe Zhvillimit është përgjegjës për koordinimin e përgjithshëm të procesit të buxhetit, duke përfshirë edhe përgatitjen e tij dhe ciklin e konsultimit të brendshëm dhe konsultimit me publikun.

Neni 79.

79.1. Konsultimet me publikun duhet të mbahen në kohën ndërmjet mesit të Prillit dhe mesit të Qershorit, në mënyrë që t'i mundësohet të gjithë qytetarëve brenda komunës që t'i japin mendimet e tyre për të hyrat dhe propozimet për investime të buxhetit.

79.2. Takimet konsultative ku përfshihen të gjitha pjesët e komunës, duhet të lajmërohen nëpërmjet mediave lokale një javë para mbajtjes së tyre dhe Drejtori i Financave, Ekonomisë dhe Zhvillimit duhet të siguroj që të gjitha propozimet për investime në infrastrukturën sociale janë evidentuar.

79.3. Propozimet duhet t'i dërgohen Komitetit për Politikë dhe Financa dhe Kuvendit Komunal së bashku me vlerësimin objektiv të Drejtorit për vlerësimin e çmimit dhe prioriteteve.

79.4. Konsultimet e buxhetit, gjithashtu përfshijnë edhe informimin e qytetarëve për potencialin e të hyrave komunale, duke përfshirë edhe tatimin në pronë dhe masën në të cilën këto të hyra do të mbliidhen.

EKZEKUTIVI I KOMUNËS

KAPITULLI IX – KRYETARI I KOMUNËS DHE ADMINISTRATA.-

Neni 80.

80.1. Kryetari i komunës zgjidhet memandat katër vjeçar konform dispozitave të ligjit mbi zgjedhjet lokale.

80.2. Me rastin e zgjedhjes, Kryetari i Komunës e benë betimin ose deklaratën solemne përpara anëtarëve të kuvendit komunal.

80.3. Forma e betimit ose deklaratës solemne është si vijon:

“ Unë _____ betohem se do ti kryej detyrat dhe do ti ushtroi kompetencat e miya si kryetar i komunës së Pejës, me nderë, besnikëri, paanshmëri, me ndërgjegje dhe në pajtim me ligjin, në mënyrë që të sigurohen kushte për një jetë të qetë për të gjithë” .

Neni 81.

81.1.Mandati i Kryetarit të Komunës mund të përfundoj vetëm sipas mënyrës së përcaktuar me nenin 56.3. të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale. Në rast të përfundimit të mandatit të kryetarit para skadimit të rregullt pa vonesë behën zgjedhjet e jashtëzakonshme për kryetar të komunës.

Neni 82.

82.1.Kryetari i komunës ushtron përgjegjësit e përcaktuara me nenin 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale.

Neni 83.

83.1.Përgjegjësit e tjera të kryetarit të komunës janë si në vijim:

- mbikqyrë administrimin e përgjithshëm financiar të komunës,
- mbikqyrë zbatimin e të gjitha akteve juridike të aprovuara nga kuvendi i komunës,
- delegon përgjegjësit të drejtorët e Drejtorive dhe mbikqyrë zbatimin e përgjegjësiave të deleguara,
- i propozon kuvendit të komunës ndryshime në lidhje me funksionin dhe numrin e Drejtorateve dhe funksionet e tyre në pajtim me legjislacionin në fuqi,
- i ofron propozime kuvendit të komunës për konstituimin, organizimin dhe koordinimin e organeve komunale si dhe krijimin e institucioneve dhe Ndërmarrjeve,
- bënë caktimin apo ndarjen dhe koordinimin e përkohshëm të punëve dhe përgjegjësiave në mes të drejtorive sipas nevojës, duke patur për bazë lëmin apo projektin e caktuar, dhe
- përgjegjësit tjera të përcaktuara nga kuvendi komunal.

Neni.84.

84.1.Në ushtrimin e përgjegjësiave të veta kryetari i komunës ndihmohet nga nënkryetarët dhe drejtoret komunal.

Nënkryetarët e Komunës

Neni 85.

85.1. Kryetari ka një nënkryetar dhe një nënkryetar për komunitete.
85.2. Nënkryetari emërohet nga kryetari për të njëjtin mandat dhe shkarkohet nga kryetari.

85.3. Nënkryetari i komunës për komunitete emërohet dhe shkarkohet në propozim të kryetarit të komunës. Propozimi i kryetarit duhet të miratohet:
a) nga shumica e anëtarëve të pranishëm të kuvendit të komunës, dhe
b) shumica e anëtarëve të kuvendit të komunës që janë të pranishëm dhe votojnë të cilët i përkasin komuniteteve jo shumicë.

85.4. Nënkryetari për komunitete do të ndihmoi kryetarit dhe do të ofroj këshilla dhe udhëzime për kryetarin lidhur me çështjet që kan të bëjnë me komunitetin pakicë.

Neni 86.

86.1. Kryetari dhe nënkryetarët e komunës janë të obliguar të paraqesin konfliktet e interesit sapo të paraqiten ato.

86.2. Kryetari dhe nënkryetarët e komunës përjashtohen nga procedurat vendimmarëse dhe administrative që kan të bëjnë me ndonjë çështje, në të cilën ata apo ndonjë anëtar i familjes së tyre kan interesa personale apo financiare.

KAPITULLI X.: DREJTORIT KOMUNALE

Neni 87.

87.1. Administrata komunale organizohet në Drejtorate.

87.2. Drejtoratet komunale menaxhohen nga Drejtorët të cilët emërohen dhe shkarkohen nga Kryetari i komunës.

87.3. Drejtoritë komunale janë:

- 1). Drejtoria e Administratës,
- 2). Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale,
- 3). Drejtoria e Arsimit dhe Kulturës,
- 4). Drejtoria e Financave, Ekonomisë dhe Zhvillimit,
- 5). Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Ambientit.
- 6). Drejtoria për Punë Komunale dhe Shërbime Publike,
- 7). Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim,
- 8). Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi,

- 9). Drejtoria për Punë Inspektuese, si dhe
10). Zyra Komunale për Komunitete.

Neni 88.

1. Drejtoria për Administratë.

88.1. Drejtori i Drejtorisë së Administratës, vepron nën përgjegjësin e përgjithshme të Kuvendit të Komunës dhe Kryetarit të Komunës;

- a) kujdeset për ligjshmërinë e punës së Drejtorive komunale,
- b) Kujdeset për përgatitjen dhe mbajtjen e shënimeve për tokën dhe objektet të cilat i posedon apo i shfrytëzon komuna.
- c) Kujdeset për përgatitjen dhe mbajtjen e një inventari të mjaftueshëm për tërë pasurinë e tundshme që e posedon komuna,
- d) Përgatit propozimin e vendimeve dhe rregulloreve komunale, që i propozohen kuvendit për miratim,
- e) Përcjellë implementimin e rregulloreve komunale.
- f) Ai/ajo do të përgatitë propozime për aprovimin apo ndryshimin e rregulloreve komunale sipas nevojës.
- g) Kryen edhe punë dhe detyra që i caktohen me ligj, statut, rregullore apo punët që i ngarkohen nga Kryetari i Komunës dhe Kuvendi i Komunës.
- h) Zyra e prokurimit mban regjistrin e hollësishëm të gjitha prokurimeve të kryera brenda vitit,

Neni 89.

2. Drejtoria për Shëndetësisë dhe Mirëqenie Sociale

89.1. Kjo Drejtori është përgjegjëse për:

- a) ofrimin e kujdesit shëndetësor parësor në komunë, në pajtim me dispozitat ligjore;
- b) inspektimin e qendrave private të përkujdesit primar shëndetësore;
- c) vlerësimin e nevojave lokale për shëndetësi primare;
- d) vendosjen e objektivave lokale për kujdesin primar shëndetësor;
- e) zhvillimin e buxhetit bazuar në nevojat lokale dhe duke respektuar udhëzimet e MSH;
- f) koordinon dhe mbikëqyrë punën e QKMF, QMF dhe Ambulancave;
- g) operimin e qendrave për punë sociale dhe qendrave për mirëqenie sociale;
- h) zhvillimin e planit strehimor për territorin e komunës;
- i) sigurimin e ofrimit të shërbimeve sociale dhe familjare brenda territorit, sipas standardeve të përcaktuara nga MPMS; dhe
- j) punë tjera të caktuara nga Kryetari i Komunës.

Neni 90.

3. Drejtoria e Arsimit dhe Kulturës

90.1. Kjo Drejtori është përgjegjëse për:

- a) planifikon zhvillimin e arsimit parashkollor, fillor, të mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë në komunë në bashkëpunim të ngushtë me MASH.
- b) nxitë bashkëpunimin midis personelit arsimor në raport me nxënësit dhe prindërit;
- c) siguron mirëmbajtjen dhe riparimin e objekteve shkollore dhe objekteve tjera përcjellëse me fondet publike të siguruara;
- d) nxjerrë rregulla disiplinore për sjelljen dhe disiplinën e nxënësve ;
- e) zgjedhjen e Drejtorit dhe / ose Zëvendësdrejtorit të institucioneve edukativo – arsimore në pajtim me procedurat ligjore për rekrutimin e tijë dhe kriterëve ligjore të përcaktuara nga MASHT.-i nga një Komision i caktuar nga Kuvendi Komunal në të cilin dy anëtarë do të jenë nga Komuna dhe një nga MASHT.-i;
- f) mbikqyrjen e procesit arsimor në pajtim me udhëzimin e përcaktuar nga MASHT.-i;
- g) monitorimin dhe raportimin e menaxhimit të veprimtarive arsimore në komunë që kryhet nëpërmjet organit administrativ komunal të identifikuar si kompetent për atë funksion nga Kryetari i Komunës;
- h) menaxhon në mënyrë të drejtë me të gjitha objektet komunale të kulturës sportit dhe rinisë;
- i) organizon takime me rëndësi kulturore, sportive dhe të rinisë për komunën;
- j) organizon debate për zhvillimin e kulturës, sportit dhe rinisë në komunë;
- k) mban shënime mbi të ariturat kulturore, sportive dhe të rinisë në komunë;
- l) zhvillon planin për mbështetjen e aktiviteteve kulturore, sportive dhe rinore;
- m) punë tjera të caktuara nga Kryetari i Komunës.

Neni 91.

4. Drejtoria e Financave, Ekonomisë dhe Zhvillimit

91.1. Kjo Drejtori është përgjegjëse për:

- a) Hartimin dhe zbatimin e rregulloreve komunale për çështjet financiare, lëshon fatura për grumbullimin e tatimeve, taksave dhe taksave për reklama pano që janë në kompetencë të komunës, si dhe kryen punë tjera të përcaktuara me ligj,
- b) Ndhmon Kryetarin e Komunës në përgatitjen e projekt –buxhetit
- c) Është përgjegjës për mbajtjen e llogarive dhe raporteve financiare vjetore

- d) Është përgjegjës për menaxhimin e thesarit nën mbikëqyrjen e Kryetarit të Komunës
- e) Është përgjegjës për mbikëqyrjen dhe monitorimin e sistemeve dhe procedurave për ekzekutimin e buxhetit.
- f) Përgatit procedurat dhe raportet e kontabilitetit;
- g) Jep këshilla profesionale nga fusha e buxhetet organeve komunale;
- h) Harton planin për zhvillimin të qëndrueshëm ekonomik të komunës;
- i) Harton plane konkrete për zhvillimin e industrisë zejtare;
- j) Harton planin për shfrytëzimin e burimeve ekonomike që janë brenda komunës;
- k) Harton plane konkrete për zhvillimin e turizmit;**
- l) Krijon kushte të qëndrueshme për zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme,
- m) Punë tjera të caktuara nga kryetari i komunës.
- n) Lëshimin e lejeve për shërbime duke përfshirë edhe transportin lokal publik dhe shërbimin e taksive, si dhe leje tjera të përcaktuara me ligj.

Neni 92.

5. Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit

92.1. Kjo Drejtori është përgjegjëse për:

- a) Hartimin e planit zhvillimor të komunës;
- b) Bënë hartimin e planit zhvillimor komunal, urban dhe planeve rregullative sipas Ligjit për Planifikim Hapsiror.**
- c) Zbaton kriteret për dhënien e lejes së ndërtimit**
- d) Harton kriteret për dhënien me qera të objekteve komunale dhe tokës ndërtimore të komunës;
- e) Mban evidencën për emërtimet e vendbanimeve, rrugëve, shesheve si dhe numrat e objekteve dhe shtëpive brenda territorit të komunës;
- f) Bënë vlerësimin e pronës sipas kriterëve dhe standardeve të caktuara me legjislacionin në fuqi;
- g) Mban regjistrin e hollësishëm të të gjitha lejeve ndërtimore të lëshuara nga drejtoria brenda viti fiskal,

Neni 93.

6. Drejtoria për Punë Komunale dhe Shërbime Publike.

93.1. Kjo Drejtori është përgjegjëse për:

- a) Ofrimin e shërbimeve publike lokale dhe të infrastrukturës, duke përfshirë: furnizimin me ujë, ujësjellësin dhe kanalizimin, përpunimin e ujërave të zeza, mirëmbajtjen e rrugëve lokale,

- b) Sigurimin dhe mirëmbajtjen e parqeve publike, hapësirave të hapura dhe varrezave,

Neni 94.

7. Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim.

94.1. Kjo Drejtori është përgjegjëse për:

- a) Organizmin e mbrojtjes nga zjarri, fatkeqësitë natyrore dhe nga fatkeqësitë tjera, si dhe përcakton masat për mbrojtje dhe shpëtim konform Ligjit Nr.02/L-68.
- b) Kujdeset për zbatimin dhe përparimin e masave të mbrojtjes nga zjarri, uji, vërshimet dhe fatkeqësitë tjera elementare,
- c) Nxjerrë Planin e mbrojtjes nga zjarri në mbështetje të vlerësimit të rrezikut nga zjarri në pajtim me udhëzimet e lëshuara nga Ministria,
- d) Përcjelljen dhe zbatimin e planit të mbrojtjes nga zjarri, së paku njëherë në vit,
- e) Harmonizimin e planeve emergjente me planet tjera si dhe me Planin e ri Urbanistik,
- f) Bënë organizimin e shërbimeve tjera që hyjnë nën përgjegjësinë e kësaj drejtorie (si oxhaktarëve etj.),
- g) Bashkëpunon ngushtë me KFOR.-in, SHPK.-në, dhe FSK.-ës në sferën e detyrave dhe kompetencave të saj, si dhe kryen punët tjera të caktuara me ligj.

Neni 95.

8. Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi.

95.2. Kjo Drejtori është përgjegjëse:

- a) Harton dhe zbaton, mban politikat e zhvillimit të bujqësisë, pylltarisë dhe hidroekonomisë, dhe blegtorisë,
- b) Evidencën për tokat bujqësore, tokat e pa punuara, të dhëna në shfrytëzim dhe evidencën për token të cilës i është ndryshuar destinomi i shfrytëzimit,
- c) Kujdeset për zbatimin e rregullatave ligjore nga lamijsia e bujqësisë, blegtorisë, pylltarisë dhe hidroekonomisë etj.

Neni 96.

9. Drejtorja për Punë Inspektuese.

96.1. Kjo Drejtori është përgjegjëse për:

- a) Inspektimin e objekteve të ndërtimit, kolektive, private, afariste, kanalizimit, ujërave fekale,

- b) Inspektimin në fushën e Sanitarisë,
- c) Inspektimin në fushën e veterinarisë,
- d) Inspektimin në fushën e mbrojtjes së ambientit,
- e) Inspektimin e veprimtarive afariste ekonomike dhe bizneseve të ndryshme,
- f) Inspektimin e shërbimeve komunale (rrugëve, shesheve, parqeve, varrezave të qytetit, përcjelljen e trafikut të Auto – taxive, Kombi – Taxi, Autobusëve dhe automjeteve për transport, reklamave të ndryshme të bizneseve etj.).
- g) Inspektimin e pronave ku sigurohet zbatimi ligjeve të pronës dhe po ashtu edhe të ligjeve dhe të rregulloreve tjera që janë lidhur me sistemin e pronës,
- h) Inspektimin e kushteve të punës dhe kryerja e punëve tjera inspektuese konform ligjeve në fuqi.

Neni 97.

10.Zyrja Komunale për Komunitete.

97.2.Kjo zyre është përgjegjëse për :

- a) Përmirësimin e mbrojtjes së të drejtave të komuniteteve dhe sigurimin e qasjes të barabartë të komuniteteve në shërbimet publike në nivel komunal, si dhe kryen veprime tjera në interes të mbrojtjes dhe realizimit të të drejtave të komuniteteve në harmoni me ligjet në fuqi.

97.3.Zyra për komunitete është pjesë integrale e komunës dhe e strukturës së administratës komunale.

97.4.Nënzyrat do të themelohen nëse do të jenë të nevojshme për ofrimin e shërbimeve publike të sigurta dhe të lira.

97.5.Shefi i zyrës është anëtar i Bordit të drejtorëve të Komunës sipas detyrës zyrtare. Ai raporton në secilën mbledhje të komitetit për komunitete për punët e kryera për të cilat është përgjegjëse ajo zyre.

PJESA VI – SHËRBIMI CIVIL KOMUNAL

Neni 98.

98.1.Shërbimi civil komunal udhëhiqet në bazë të parimeve dhe procedurave të përcaktuara me legjislacionin në fuqi. Me rastin e rekrutimit të personelit të komunës duhet respektuar procedurat e hapura dhe konkurruese për të pranuar shërbyes civil të komunës me kualitet të lartë, në bazë të meritave dhe kompetencave.

Neni 99.

99.1. Administrata komunale ka Udhëheqësin e Përsoneelit..

Neni 100.

100.1. Punësimi në shërbimin civil komunal duhet të mbikëqyret dhe rregullohet nga Udhëheqësi i Personelit për të siguruar që shërbimi civil të reflekton proporcion të drejtë profesional, gjinor dhe etnik.

100.2. Kryetari shpall, rekruton udhëheqësin e përsoneelit në pajtim me ligjin e aplikueshëm të SHCK.

Neni 101.

1001.1. Shërbimi Civil Komunal si tërësi duhet që të përmbajë proporcion të drejtë të përfaqësimit të personave me aftësi të kufizuara.

Neni 102.

102.1. Kryetari i Komunës në bashkëpunim me Drejtorin e Administratës dhe Udhëheqësin e Personelit do të emërojë një nën – komision detyrat e të cilit do të jenë këshillimi dhe konsultimi në përgjithësi për çështjet e resurseve njerëzore që kanë të bëjnë me shërbimin civil komunal në veçanti me çështjet në vijim:

- a) Kategoritë dhe numrat për kategori
- b) Mbikëqyrja dhe përgjegjësit
- c) Detyrat dhe obligimet
- d) Delegimi i detyrave dhe obligimeve
- e) Rekrutimi dhe përzgjedhja
- f) Kushtet e pranimit
- g) Fillimi i punës në zyrë, puna provuese dhe lista rezervë
- h) Procedurat ankimore
- i) Procedurat e kundërshtimeve
- j) Trajnimi dhe provimet
- k) Rishqyrtimi i paraqitjes dhe procedurat e vlerësimit
- l) Përparimi dhe sukcesi në karrierë
- m) Dosjet dhe referencat e stafit
- n) Kohëzgjatja e punësimit dhe njoftimi mbi pushimin e marrëdhënies së punësimit
- o) Pagesat dhe shpërblimet tjera
- p) Pagesa për udhëtim dhe mëditjet
- q) Pushimi
- r) Rregullat e shërbimit civil komunal

PJESA VII. DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 103.

103.1. Në rastet kur ekziston ndonjë konflikt midis dispozitave statutore me dispozitat e Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, dispozitat e Ligjit do të mbizotërojnë.

Neni 104.

104.1. Ky Statut hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Kuvendi i Komunës dhe nëshkrimit të tij nga Kryesuesi i Kuvendit Komunal.

Neni 105.

105.1. Pas hyrjes në fuqi të këtij Statuti pushojnë të vlejshme të gjitha dispozitat e Statutit të Komunës së Pejës, 01.Nr. 020 - 2880 datë 31.Mars 2008 dhe aktet komunale të mëparshme në ato pjesë ku janë në kundërshtim me statutin e komunës.

Neni 106.

106.1. Me aprovimin e këtij statuti të gjitha aktet tjera të komunës do të harmonizohen me statutin në afat prej 60 ditësh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij statuti.


Neni 107.

106.1. Interpretimi autentik i këtij statuti bëhet nga Kuvendi i Komunës.

01.Numër: 09 - 8103

Pejë, datë: 29.Shtator 2008.

REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI KOMUNAL PEJË



KRYESUESI
Prof.Dr.Ali Sylqja

Dëshimi mbi dorëzimin e

STATUTIT TË KOMUNËS SË PEJËS, i miratuar dhe e dhënë në implementim nga Kuvendi Komunal Pejë, me date: 29.Shtator 2008.

Drejtorisë e Shërbimit Civil Komunal Pejë :

- 1.Drejtorija për Administratë dhe Përsonei *[Signature]*
- 2.Drejtorija e Shëndetësisë dhe Mirëqenjes Sociale, *[Signature]*
- 3.Drejtorija e Arsimit dhe Kulturës, *[Signature]*
- 4.Drejtorija e Financave, Ekonomisë dhe Zhvillimit, *[Signature]*
- 5.Drejtorija e Urbanizimit, K.M.A. *[Signature]* *Blindon për Bleruse Komuni*
- 6.Drejtorija për Punë Komunale e SH.T. *[Signature]*
- 7.Drejtorija për Mbrojtje dhe Shpetim., *[Signature]*
- 8.Drejtorija për Bujqësi, Pylltari e Hidrek., *[Signature]*
- 9.Drejtorija për Punë Inspektuese, 16.10.08 *[Signature]*
- 10.Zyra Komunale e Komuniteteve, *[Signature]*

Pejë, date: 08.Tetor 2008.